Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**01.11.2023**	**08.11.2023**	**2023/0851**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 30.10.2023, **OE "Euro-Services Shpk & Top Projekt"- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0851**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE "EBK Shpk &Univers-MI"- Prishtinë,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Ndertimi i objektit te FSHMU ne Fushtice te Eperme faza II – Komoran Drenas**" me nr. të prokurimit: **"214-23-5061-5-1-1",** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **727,721.07 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Te nderuar,

Grupi i Operatori Ekonomik "Euro Services shpk & Top Projekt" shpk - Prishtine, pjesëmarrës ne procedurën e prokurimit me titull: *"Ndërtimi i objektit te FSHMU ne Fushtice te epërme -faza II - Komoran Drenas,* me nr prokurimi: *214-23-5061-5-1-1,* ne afatin parapare me nenin 108/A, te LPP-se, konkretisht me datën 16.10.2023, ka parashtruar kërkese për ri shqyrtim te vendimit te AK-se, propozimit për dhënie te kontratës, ku grupi ynë i OE-ve konsideron se për dhënie te kontratës eshtë rekomanduar Operatori Ekonomik i pa përgjegjshëm, ne kundërshtim me dispozitat ligjore dhe me gjendjen faktike, rrjedhimisht zyra e prokurimit te AK - MPB, përkatësisht komisioni i vlerësimit te

ofertave nuk ka zbatuar dispozitat e nenit 59, te LPP-se ne tërësi dhe rregullat tjera nënligjore, rrjedhimisht nuk jane trajtuar pretendimet tona ankimore ne ate forme sic përcaktohet me dispozita ligjore te nenit 108/A, te LPP-se.

Përkundër këtij fakti kërkesa jone për ri shqyrtim te vendimit, me datën 19.10.2023, sipas vendimit te AK-se neve na refuzohet si e pa bazuar, prandaj ne kuptim te nenit 109 te LPP-se, paraqesim ketë ANKESE:

Pretendimet ankimore:

Autoriteti Kontraktues - Ministria e Punëve te Brendshme, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ka kërkuar:

*"OE ose grupi i OE-ve duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte ne lëmin e ndërtimit te larte dhe renovimit te objekteve te larta nga (njoftimi për kontrate për periudhën e shkuar tre vjeçare) ne vlere prej te gjithë se bashku jo me pak se **1,000,000.00** €"*

Si dëshmi Dokumentare AK - MPB, ka kërkuar:

"Lista e projekteve te përfunduara origjinal e vulosur dhe nënshkruar nga OE per projekte te realizuara, duke bashkangjitur referenca ose procesverbalet e pranimit përfundimtar te punëve duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit te projektit".

Grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës "EBK shpk & Universi MI, pothuaj se te gjitha projektet e prezantuara ne oferte, janë te realizuara nga operator ekonomik tjetër ku te njëjtit janë te deklaruar vetëm si anëtar te grupit jo lider te grupit ne projektet e prezantuara ne oferte. Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontrate OE EBK shpk, te gjitha projektet e prezantuara ne oferte i ka te realizuara nga operator ekonomik tjetër "Construmax"shpk.

Ne si OE ankues përmes kërkesës për ri shqyrtim te vendimit te AK-se, kemi kërkuar nga AK, qe te paktën te kërkoi sqarim shtese dhe te bëjnë ndarjen e projekteve te prezantuara si te realizuara, te kërkoi nga OE qe te prezantoj prova konkrete përmes te cilave vërtetohet pjesa dhe vlera e cia leshte realizuar nga operatori ekonomik i propozuar për dhënie te kontratës, siç janë transaksionet bankare, marrëveshjet kontraktuarle ne mes te grupit te OE-ve ndarja ne përqindje apo dëshmi tjera.

Referenca edhe përshkrimi i emrit te OE, si anëtar i grupit nuk dëshmon se ka realizuar projekte sipas kërkesës se AK-se. AK - MPB përveç se ka kërkuar dëshmi për projekte ka përcaktuar edhe vlerën e projekteve te realizuara. OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ne asnjë rrethane nuk ka prezantuar dëshmi apo edhe AK nuk e ka vërtetuar nëse kërkesa dhe dëshmia dokumentare mbulohet me prova.

Neni 59, i ligjit për prokurim publik e obligon komisionin vlerësues te ofertave qe te beje ekzaminim dhe krahasim te ofertave, AK sipas raportit te vlerësimit te ofertave nuk e ka bere një gjë te tille

Projektet e poshtë shënuara janë projekte te realizuara nga OE tjetër dhe jo nga OE i rekomanduar

për dhënie te kontratës.

Renovimi i komunës - Përdheses dhe kulmit ne Prizren, aneks kontrate loti 1 dhe 2.

Ndërtimi i sallës se edukatës fizike ne shkollën dëshmoret e Zhurit faza II e

Ndërtimi i ndërtesave qeveritare dhe institucioneve Arsimore, e shumë projekte tjera janë projekte te realizuara nga OE tjerë dhe AK- MPB, komisioni i vlerësimit te ofertave nuk ka argumentuar se te njëjtat projekte janë realizuar nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës.

Ngjashëm, projekte te tilla ka prezantuar edhe anëtari tjetër i grupit, ku AK, fare lehtë ka mundur qe te vërtetoi nëse OE i rekomanduar për dhënie se bashku me anëtarin e grupit e mbulojnë kërkesën kualifikuese dhe vlerën e projekteve.

Transaksionet bankare argumentojnë një gjë te tille. Çuditërisht AK -MPB, komisioni i vlerësimit te ofertave nuk ka kërkuar një sqarim dhe nuk e ka argumentuar gjendjen faktike dhe vlerën konkrete te realizuar nga operatoret ekonomik pjesëmarrës ne ketë procedurë te prokurimit.

Si prove ne si OE, për konsistence ne vendimmarrje kemi bashkangjitur vendimet e OSHP-se me nr. 834/20 ; 1040/20 dhe interpretime te KRPP-se.

Grupi i OE-ve te propozuar për dhënie te kontratës eshtë i pa përgjegjshme edhe për faktin se menaxheri i projektit dhe stafi tjetër profesional nuk posedojnë kualifikimet adekuate, nuk posedojnë referenca dhe nuk e mbulojnë përvojën e punës sipas periudhës kohore ashtu siç eshtë kërkuar te dosje te tenderit dhe njoftim për kontrate.

Ne pozicionin 5, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional eshtë kërkuar menaxheri i projektit me minimumin 8 vite përvoje pune.

Ne dëshmi dokumentare eshtë kërkuar CV e nënshkruar, eshtë kërkuar **Reference për përvojën e punës për punët e mëparshme për mbikëqyrje ne lëmin e ndërtimit te larte.**

Menaxheri i projektit i prezantuar ne ketë projekt nuk ka dëshmi - Reference ku argumentohet se i njëjti ka menaxhuar projekte qe kane te bëjnë me ndertin e larte ashtu siç eshtë kërkuar tek kërkesat kualifikuese.

Prove: CV dhe Referencat për pune te realizuara i gjeni ne ofertën e OE te propozuar për dhënie te kontratës.

Ngjashëm eshtë vepruar edhe me pjesën tjetër te stafit, ku operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk ka prezantuar dëshmi dhe prova ne atë forme siç eshtë kërkuar ne kërkesat kualifikuese, sa i përket përvojës se punës specifike dhe periudhës kohore, prandaj komisioni i vlerësimit te ofertave nuk bere vlerësim krahasim dhe ekzaminim konkret te ofertave ku me këto veprime janë shkelura parimet e prokurimit publik, rrjedhimisht eshtë propozuar për dhënie te kontratës oferte e pa përgjegjshme.

3. Operatori Ekonomik tjetër i radhitur i dyti për nga çmimi "AC Ing" shpk, ngjashëm sikurse grupi i OE-ve te propozuar për dhënie te kontratës, nuk i plotëson ne tërësi kërkesat e

kualifikimit qe kane te bëjnë me kapacitetin teknik dhe profesional. Sa i përket projekteve te realizuara i njëjti OE ne oferte ka prezantuar projekte te realizuara nga operatori ekonomik AAG Projekt, ne cilësi te liderit te grupit, rrjedhimisht AK — MPB, komisioni vlerësues i ofertave nuk ka bere ndarjen e projekteve dhe vlerën e projekteve te cilat janë realizuar nga OE AC Ing shpk.

Prove: Referencat - Projektet e realizuara i gjeni ne ofertën e OE "AC Ing" shpk, ku shumica e projekteve janë realizuar nga anëtari i grupit AAG Projekt.

AK - MPB, komisioni vlerësues i ofertave si arsyetim te dhënies se kontratës i referohet përgjigjes ndaj kërkesës për interpretim te dhëne nga KRPP, ku interpretimi eshtë shumë i qarte dhe i njëjti ka rekomanduar AK, ne qe te respektoi dispozitat ligjore dhe kërkesat e aplikuara ne dosje te tenderit dhe ne njoftim për kontrate. Pra vet interpretimi i KRPP-se, përcakton qe operatori ekonomik duhet te dëshmoj me Raportin përfundimtar te kryerjes se punëve apo certifikata për kryerjen dhe/ose përfundimin e kënaqeshim te projekteve.

Përkundër kësaj AK, nuk ka marr konfirmim nga grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës si dhe nga OE i radhitur i dyti për nga çmimi se cila eshtë vlera e saktë e projekteve te realizuara dhe te prezantuara ne oferte. Te gjitha këto prova dhe dëshmi te prezantuara si me larte argumentojnë se AK - MPB, komisioni i vlerësimit te ofertave, ka shkelur dispozitat ligjore, ka shkelur parimet e prokurimit publik dhe ka rekomanduar për dhënie e te kontratës OE te pa përgjegjshëm ne raport me kërkesat kualifikuese, prandaj grupi i OE-ve ankues kërkon qe pretendimet tona te trajtohen ne tërësi, përkatësisht paneli shqyrtues ne kuptim te nenit 105 te LPP-se te nxjerri ketë:

VENDIM

Te aprovohet ankesa jone ne tërësi si e bazuar

Te kthehet lënda ne ri vlerësim

Si përfundim kërkojmë qe eksperti shqyrtues i autorizuar te ketë parasysh gjendjen faktike dispozitat ligjore dhe ne kuptim te nenit 113 te LPP-se, ti trajtoj pretendimet tona ankimore ne atë mënyre qe paneli shqyrtues përmes vendimit ta obligoi AK-ne qe ti korrigjoi shkeljet ligjore.

KRITERET PËR VLERËSIM

4. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte në lëmin e ndërtimit të lartë dhe renovimeve të objekteve të larta nga (Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) në vlerë prej të gjitha së bashku jo më pak se 1.000,000.00 Euro.	**4. Lista e projekteve të përfunduara Origjinal e vulosur dhe e nënshkruar nga OE për projekte e realizuara, duke bashkëngjitur referenca ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit të projektit.**
5. OE duhet të paraqes Një (1) Menaxher <u>të projektit</u> i cili duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master i Ndërtimtarisë drejtimi - konstruktiv ose Inxhinier i Diplomuar ose Master i arkitekturës - min. 8 vjet përvojë punë pas diplomimit dhe përvojë në menaxhimin e projekteve në ndërtim <u>të lartë sepaku</u> 1 projekt <u>të perfunduara</u>.	**5. Për menaxherin e Projektit të paraqiten Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër se 3 muaj nga data e njoftimit për kontratë , CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi – (origjinal), Referencat për përvojën e punës dhe referenca për punët e mëparshme për mbikëqyrje në lëmin e ndërtimit të lartë të lëshuara nga punëdhënësit, që duhet të përmbajnë titullin e projektit, vlerën e projektit, vendin e ekzekutimit të projektit për të cilët lëshohet referenca.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: "Ndërtimi i objektit të FSHMU në Fushticë të Epërme faza II – Komoran Drenas"

Nr. i prokurimit	**214-23-1473-5-1-1**

Nr.	**Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik**	**Vlera totale e ofertave**
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik EBK SH.P.K.; N.P.N. UNIVERS- MI, BUJAR GODENI P.N. H2K1N3, 20000, Prizren	624,000.00€
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik Euro-Services shpk; Top Projekt SH.P.K., Nena terez 49/1, 10000, Prishtinë	687,901.10€
3.	" Kompania Prishtina " Sh.p.k, SELMAN RIZA NR.10, 10000, PRISHTINË	678,678.00€
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik "Euro Project " SH.P.K.; BENI COMPANY SH.P.K., Abaz Thaqi Nr.6, 41000, Skenderaj	665,059.83€
5.	" AC ing " SH.P.K., Qendra Tregtare Bregu i Diellit, Lok.Nr.47, - , Prishtinë	672,023.97€
6.	Grup i Operatorëve Ekonomik ENGINEERING RK SH.P.K.; GASHI ING SH.P.K, rruga Hoxhe Jonuzi nr 86, 61000, Viti	701,601.00€

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Ministria e Punëve të Brendshme shpërblen me kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik EBK SH.P.K.; N.P.N. & UNIVERS- MI, Bujar Godeni - Prizren në vlerë prej 624,000.00€.

Data: **11.10.2023**

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **euro-services shpk**

Aktiviteti i prokurimit: "**Ndertimi i objektit te FSHMU ne Fushtice te Eperme faza II – Komoran Drenas**" me nr. të prokurimit: **"214-23-5061-5-1-1",** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME,** ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 23.05.2023, procedurë e hapur, hapja e ofertave është bërë me datë 04.07.2023, njoftimi mbi vendimin e AK-së publikohet me datë 11.10.2023.

OE ankuesi shpallet i pasuksesshëm me çmimin më të lartë.

I njëjti pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, me datë 30.10.2023 parashtron ankesë në OSHP, duke pretenduar se AK ka shkel nenet: 7, 52, 59, 60, 69, 108/A të LPP-së.

Pretendimet e OE ankuesit janë të parashtruara kundër OE të rekomanduarit si dhe kundër OE "AC Ing"SHPK.

Pretendimi i parë i OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

Grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës "EBK Shpk & Universi MI, pothuajse te gjitha projektet e prezantuara ne oferte, janë te realizuara nga operator ekonomiktjetër ku te njëjtit janë te deklaruar vetëm si anëtar te grupit jo lider te grupit ne projektet e prezantuaraneoferte

ProjekteteposhtëshënuarajanëprojekteterealizuarangaOEtjetërdhejongaOEirekomanduarpërdhëniete kontratës.

***Renovimiikomunës -Përdheses**dhe**kulmit ne**Prizren,**aneks**kontrateloti1dhe2.*

*Ndërtimiisallësseedukatësfizikeneshkollëndëshmorete**Zhurit faza**IIe*

NdërtimiindërtesaveqeveritaredheinstitucioneveArsimore, eshumëprojekte tjera janë projektete realizuarangaOEtjerë dheAK-MPB, komisioniivlerësimit te ofertavenuk ka argumentuarse te njëjtat projekte janë realizuarnga OE irekomanduarpërdhënietekontratës.

Përgjigje në pretendimin e parë të OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

Ekspertja shqyrtuese sqaron se, AK në DT ka kërkuar: **"Kapacitetet teknike/profesionale":**

4. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte në lëmin e ndërtimit të lartë dhe renovimeve të objekteve të larta nga (Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) në vlerë prej të gjitha së bashku jo më pak se 1.000,000.00 Euro.

Dëshmia:4. Lista e projekteve të përfunduara Origjinal e vulosur dhe e nënshkruar nga OE për

projekte e realizuara, duke bashkëngjitur referenca ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit të projektit.

Tutje, në ofertën e OE të rekomanduarit gjendet lista e projekteve e cila në total përmbanë vlerën e kontratave **6,673,372.07 Euro**. Sa i përket projekteve të cilat OE ankuesi pretendon se nuk janë të përfunduara nga OE i rekomanduar por i njëjti ka qenë në konzorcium me një operator tjetër, sqarojmë se, në listë janë përfshira një numër i madhe i projekteve të përfunduara, të cilat disa janë individuale nga OE EBK SHPK, dhe disa janë në konzorcium me operator të tjerë të cilët kanë qenë anëtar të konzorciumit me OE EBK SHPK, mirëpo duke u bazuar në rregullat e prokurimit publik me nr 001/2022 neni 26-Grupi i Operatorëve Ekonomik, përkatësisht neni 26.5, 26.7 dhe 26.8, konsiderojmë se këto projekte merren si grup në tersi për faktin se OE EBK në kontratat e potencuara në ankesë nga OE ankuesi është lideri grupit/anëtar pra pjesëmarrës i grupit në projekt, dhe si e tillë grupi është përgjegjës individualisht dhe në grup për projektet, pra të cilat merren individualisht dhe në form grupore. **Andaj pretendimi i OE ankues nuk është i qëndrueshëm**, dhe si e tillë meqenëse OE EBK është pjesëmarrës në ato kontrata të përfunduara atëherë konsideroj se merren të mirëqenë.

Rrpp 001/2022 për PP, Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik

26.5 Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Çertifkatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

26.7 Referencat për kontratat e realizuara mund të dëshmohen me raportin përfundimtar të kryerjes së punëve apo me çertifkata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve e cila si dëshmi përmendet në nenin 69 të LPP-së.

26.8 Nëse autoriteti kontraktues kërkon referenca për realizim të kënaqshëm të kontratave duke specifikuar minimumin e numrit të referencave në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, referencat duhet të jenë për kontratat e specifikuara në Listën e Kontratave dhe duhet të sillen nga anëtari i grupit nëse i njëjti ka qenë ekzekutues i kontratave përkatëse, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbushë nga grupi si tërësi.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova /Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE POLITIKAVE TË INXHINIERINGUT DHE MENAXHIMIT TË NDËRTESAVE
DEPARTMENT STANDARDA I POLITIKE INŽINJERINGA I MENADŽIRANJA VLADENIH ZGRADA
DEPARTMENT FOR STANDARDS AND POLICIES OF ENGINEERING AND GOVERNMENT BUILDING MANAGEMENT

REFERENCË:		DMP/DSPIMNQ/MPB			
PËR/ZA/TO:		**Iliriana Rexhepi,** Zv.– Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit –MPB			
CC:		**N.N.P. "CONSTRUMAX" – Suharekë & N.N.P. "EBK" - Prizren**			
PËRMES/PREKO/THROUGH		**Shengjyle Bektashi,** Zv. Drejtor i DSPIMNQ/MPB **Mimoza Kurteshi,** Udhëheqëse e DPPS/DSPIMN,MPB			
NGA/OD/FROM:		**Ajshe Kamberi- ida,** kryesuese e komisionit Inxhinier i projekteve arkitekturë DPPS/DSPIMNQ/MPB			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Raport Final i Komisionit për pranim teknik të punimeve finale për projektin - **"Ndërtimi i ndërtesave Qeveritare dhe Institucioneve Arsimore" – Lot 3: "Ndërtimi i institucionit Parashkollor – Çerdhes në Prizren" me numër të kontratës: 202-18-091-511 dhe nr. të e-prokurimit: 202-18-6070-5-1-1**			
Nr. i zyrës: Br. kancelarije:	**419**	Lokacioni: Kucni:	**30 041**	Data: Datum:	**20.12.2021**

PROQESVERBAL PËR PRANIM TEKNIK

Në bazë të kërkesës së operatorit ekonomik "EBK sh.p.k." me NUI 811290874 nga Przreni, Drejtoria Komunale e Arsimit Prizren, ka formuar komisionin për pranim teknik të punimeve në **ndërtimin e sallës së edukates fizike në shkollën "Dëshmorët e Zhurit" në Zhur (faza e dytë).**

- **Kontrata e Punës: Ndërtimi i sallës së edukates fizike në shkollën "Dëshmorët e Zhurit" në Zhur (faza e dytë),**
- **Nr.Prok.622-19-044-521, në vlerë prej 216,598.17€ dhe**
- **Aneks kontrata Nr.ref..622-20-214-525, në vlerë prej 20,020.00€**
- **Grup i Operatorëve Ekonomik "EBK sh.p.k." me NUI 811290874 nga Prizreni dhe "Construmax sh.p.k." me NUI 811273739 nga Suhareka**

Nga ana e Drejtorisë përkatëse është formuar komisioni në këtë përbërje:

1. Refki Muzbegu, inxh.dipl.ndërt.
2. Zana Belloda, inxh.dipl.ark.
3. Jahja Baca, ecc.dipl.

Zyra e Prokurimit/ Kancelarija Nabavke/ Office of Procurement

REFERENCË

Ministria e Administratës Publike lëshon këtë reference për kompaninë kontraktuese ***Construmax SH.P.K & EBK SH.P.K*** *nga Suhareka që ka kryer punët ndërtimore në projektin me titull:* ***''Renovimin i Komunës -Përdheses dhe Kulmit per nevoja te pilot projektit #ONESTOPSHOP# -Prizren''****me nr. prok.* ***202-19-1838-5-1-1-*** *dhe nr.i brenshëm* ***202/19/039/511 në vlerë prej 1,017,135.65 €***

Kontrata është lidhur me datën 22.07.2019-të, dhe vlera e punëve të kontraktuara është ***LOT-1 Renovimi Kulmit për nevojat te pilot projektit#ONESTOPSHOP#-Prizren 29,005.00€ dhe***
LOT-2 Renovimi i Përdheses për nevojat te pilot projektit#ONESTOPSHOP#-Prizren 900,579.68€
Anex kontrata ''Renovimin i Komunës -Përdheses dhe Kulmit per nevoja te pilot projektit #ONESTOPSHOP# -Prizren'' 87, 550.97 €
Sipas rapoerteve të Menagjerit të projektit dhe inxhinierve mbikqyrës, kompania ***Construmax SH.P.K & EBK SH.P.K*** *nga Suhareka i ka kryer të gjitha punimet e kërkuara sipas kontratës në nivel profesional dhe me dinamiken e paraparë dhe është në proces të pranimit teknik.*

Pretendimi i dytë i OE ankuesit

Grupi i OE-ve te propozuar për dhënie te kontratës është i pa përgjegjshme edhepër faktinse menaxherii projektitdhestafitjetërprofesionalnukposedojnëkualifikimet adekuate, nuk posedojnë referenca dhe nuk e mbulojnë përvojën epunës sipas periudhëskohoreashtu siç është kërkuar te dosje te tenderit dhenjoftimpërkontrate.

Ne pozicionin 5, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuarmenaxheriiprojektitmeminimumin8vitepërvojepune.

Ne dëshmi dokumentare është kërkuar CV e nënshkruar, është kërkuar **Referencepër përvojëne punës për punët** e **mëparshmepër mbikëqyrjene lëmin** e**ndërtimittelarte.**

Menaxheriiprojektitiprezantuarneketëprojektnukkadëshmi—Referencekuargumentohet se i njëjti ka menaxhuar projekte qe kane te bëjnë me ndërtim e larte ashtusiçështëkërkuartekkërkesatkualifikuese **Përgjigje në pretendimin e dytë të OE ankues kundër OE të rekomanduarit:**

Ekspertja shqyrtuese sqaron se, AK në DT ka kërkuar: "Kapacitetet teknike/profesionale":

Kërkesa e AK-së në DT:

5. OE duhet të paraqes Një (1) Menaxher të projektit i cili duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master i Ndërtimtarisë drejtimi - konstruktiv ose Inxhinier i Diplomuar ose Master i arkitekturës - min. 8 vjet përvojë punë pas diplomimit dhe përvojë në menaxhimin e projekteve në ndërtim të lartë se paku 1 projekt të përfunduara.

Dëshmia: 5. Për menaxherin e Projektit të paraqiten Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër se 3 muaj nga data e njoftimit për kontratë , CV e nënshkruar nga inxhinieri- (origjinal), kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi – (origjinal), Referencat për përvojën e punës dhe referenca për punët e mëparshme për mbikëqyrje në lëmin e ndërtimit të lartë të lëshuara nga punëdhënësit, që duhet të përmbajnë titullin e projektit, vlerën e projektit, vendin e ekzekutimit të projektit për të cilët lëshohet referenca.

Tutje, në ofertën e OE të rekomanduarit gjendet projekt menaxheri- Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv z. Bekim Mujaj, posedon vendimin mbi caktimin e menaxherit të projektit, diploma është e noterizuar me datë 03.07.2023, gjendet kontrata valide për punë me kohë të caktuar nga OE EBK SHPK, gjenden referencat për një numër të madhe të projekteve të përfunduara, të cilat janë lëshuara nga OE EBK, është në listat e ATK-së si punëtor/Inxhinier në kompaninë EBK SHPK. Pra, si e tillë konsideroj se, sa i përket menaxherit të projektit e plotëson kriterin, dhe si e tillë pretendimi nuk gjendet i qëndrueshëm, përkundër po ashtu që OE ankuesi nuk ka argumentuar me fakte të pretendimin.

Tutje, lidhur me pretendimin se edhe inxhinierët/punëtorët të tjerë të angazhuar nga kompania, të cilët OE ankues pretendon se nuk i plotësojnë kriteret e DT-së, ekspertja shqyrtuese sqaron se, inxhinierët/punëtorët të cilët janë të bashkangjitur në listën e punëtorëve, të gjithë kanë kontrata të punës me afat të caktuar, të noterizuara, përvojën e punës me referenca, diplomat e noterizuara po ashtu inxhinierët/punëtorët të cilët kanë kontratë të punës me OE EBK SHPK janë gjithashtu edhe të deklaruar në ATK si punëtor të rregullt, dhe si e tillë pretendimi I **OE ankuesit nuk gjendet I bazuar**, gjithashtu OE ankuesi edhe pretendimin në fjalë nuk ka argumentuar me fakte.

Pretendimi i OE ankuesit kundër OE AC Ing SHPK:

OperatoriEkonomiktjetëriradhituridytipërngaçmimi"ACIng" Shpk,ngjashëmsikursegrupiiOE-vetepropozuarpërdhënietekontratës,nukiplotëson në tërësi kërkesat e kualifikimit qe kane te bëjnë me kapacitetin teknikdheprofesional.Sa i përketprojektevete realizuarai njëjtiOE ne ofertekaprezantuar projekte te realizuara nga operatori ekonomik AAG Projekt, ne cilësi te liderittegrupit,rrjedhimishtAK—MPB,komisionivlerësuesiofertavenukka berendarjeneprojektevedhevlerëneprojektevetecilatjanërealizuarngaOEAC Ing Shpk.

Përgjigje në pretendimin e OE ankuesit kundër OE AC Ing SHPK:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e OE ankuesit kundër OE AC Ing SHPK sqaron.

OE AC Ing SHPK është i shpallur nga AK i pa suksesshëm me çmimin më të lartë, kurse sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me projektet e realizuara sqarojmë se, në ofertën e OE AC Ing SHPK është e bashkangjitur lista e projekteve të përfunduara në vlerë **5,716,538.98** EURO, mirëpo në listë kanë qenë projekte të cilat janë të përfunduara mbi 3 vjeç si dhe pas publikimit të njoftimit për kontratë. Pas analizimit dhe krahasimit të projekteve me datat të cilat duhet të mbeten brenda 3 viteve, atëherë gjatë kalkulimit

vërejmë se, OE AC Ing SHPK posedon **1,718,002.76** euro kontratat të mirëqenë, por vlenë të theksohet se, sa i përket pretendimit nga OE ankuesi lidhur me projektet ku OE në fjalë i ka në konsorcium me operatorët e tjera mund të sqarojmë dhe japim të njëjtën përgjigje sikur te përgjigja në pretendimin e parë kundër OE të rekomanduarit. Pra pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar duke u bazuar në rregullat e prokurimit publik me nr 001/2022 neni 26-Grupi i Operatorëve Ekonomik, përkatësisht neni 26.5, 26.7 dhe 26.8, konsiderojmë se këto projekte merren si grup në tersi për faktin se OE AC Ing në disa nga kontratat është lideri grupit/anëtar pra pjesëmarrës i grupit në projekt, dhe si e tillë grupi është përgjegjës individualisht dhe në grup për projektet.

Si përfundim, OE ankuesi ka parashtruar pretendime kundër OE ankuesit lidhur me projektet e përfunduara, të cilat I konteston sepse nuk janë projekte 100% të OE të rekomanduarit, po ashtu pretendon se menaxheri i projektit nuk posedon dokumentacionin sipas DT-së duke përfshirë edhe inxhinerët tjerë në të njëjtin pretendim, për të cilat sipas sqarimeve më lartë, ekspertja shqyrtuese pretendimet e OE ankues I gjene të pa qëndrueshme. Tutje OE ankuesi ka parashtruar pretendim edhe per OE AC Ing SHPK duke pretenduar se nuk I plotëson projektet e përfunduara 100%, gjerësa ekspertja shqyrtuese sa i përket këtij pretendimi ka sqaruar më lartë duke konsideruar pretendimin e OE ankues të pa bazuar.

Andaj, sipas sqarimeve më lartë si dhe marrë parasysh gjithashtu edhe kriterin e dhënies si çmimi më i ulët, ku OE i rekomanduar është për vlerën **63901.01euro** më i lirë se sa OE ankuesi, si e tillë atëherë **ankesa e OE ankues nuk gjendet e bazuar** si dhe rekomandoj që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **euro-services shpk**

Blerina Huruglica